

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N.P.T. “Lindi”, NUI 810587561, NRB 80575769, rr. Muharrem Bekteshi, nr. 45, Prizren, me pronar H.H., kundër debitorit SHSKUK – Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës me NRB 95000304 dhe NF 601789920, Lagja e Spitalit, Prishtinë, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1590/22 i datës 28.07.2023, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit N.P.T. “Lindi”, NUI 810587561, NRB 80575769, rr. Muharrem Bekteshi, nr. 45, Prizren, me pronar H.H, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1590/22 i datës 28.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1590/22 i datës 28.07.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit SHSKUK – Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës me NRB 95000304 dhe NF 601789920, Lagja e Spitalit, Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.23/22 i datës 18.01.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë dhe e ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimor dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet në tërësi ankesa e kreditorit si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.1590/22 i datës 28.07.2023 në atë mënyrë që urdhrin përmbartimor P.nr.23/2022 i datës 18.01.2022 të mbetet në fuqi, ose lenden ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallë të parë.

Ankesa e të autorizuarës së kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, N.P.T. "Lindi", NUI 810587561, ka caktuar urdhrin përmbarimor P.nr.23/22 të datës 18.01.2022 duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës me numër 21-SHV1-001-1408 të datës 21.12.2021 me të cilën detyrohet debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat më sipër, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguan kreditorit shumën prej 34,216.87 Euro, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar propozimin e kreditorit për përmbarim si të pabazë, duke theksuar se kreditori dhe debitori kanë nënshkruar kontratën me nr.701-20-290-111 me dt.09.12.2020, për Furnizim me rezervar të Oksigjenit të lëngët medicinal dhe instalimi i tyre në Spitalet e SHSKUK, sipas të cilës punët kanë filluar nga data 14.12.2020 të cilat është dashtë të kryhen brenda 87 ditëve dhe kanë qenë të parapara të kryhen me dt.11.05.2021. Shton se kreditori është vonuar në realizimin e projektit 2.0 Furnizimi dhe montimi i rezervuarëve të oksigjenit të lëngët, e që në bazë të raportit të menaxherit të kontratës këto punë kanë përfunduar me dt. 10.12.2020, do të thotë se kreditori është me vonesë prej 210 ditë. Tutje thekson se në bazë të nenit 16.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës për shkak të vonesës, kreditori është penalizuar dhe i është shqiptuar dënimi për vonës prej 210 ditëve në vlerë prej 34,216.87 €, ndërsa për pjesën tjetër të punëve të kryera debitori e ka përmbushur obligimin ndaj kreditorit për pagesën e Faturës nr. 21- SHV01-001-1408 në shumë prej 64,432.53 që mund të konfirmohet nga urdhri i pagesës 2021- 49546 i dt.24.12.202. Nga gjykata ka kërkuar të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të shfuqizohet Urdhri për caktimin e përmbarimit P.nr.23/22 i dt.18.01.2022.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit duke e kundërshtuar vonesën e implementimit të kontratës siç pretendon debitori. Shton se firma e tyre në afat rekord e ka bërë instalimin e rezervarëve nëpër të gjitha lokacionet e caktuara nga QKUK. Vonesa e instalimit të rezervarëve është bërë për shkak të mbylljeve nga Qeveria, po kjo nuk ka ndikuar në asnjë mënyrë në dëmtimin e debitorit sepse është vendosur nga partneret tanë rezervari prej 20000L, i cili është ende në funksion. Tutje thekson se nga vlera e kontratës se përgjithshme në shumë prej 447,627.40 Euro, është e vërtetë se ka pasur vonesë në instalimin e rezervarëve 20000L vlera e të cilit është 63,975.00 Euro dhe për këtë shumë QKUK ka të drejtë të inkasoj dënimin për vonesë, por jo për totalin, sepse punët janë kryer me afat dhe QKUK kanë kursyer mbi 2 Milion Euro, fakt të cilin vete e kanë deklaruar në mjetet e informimit. Po ashtu shton se fakti tjetër që prokurimi i QKUK-së ka kërkuar vazhdimin e sigurimi të tenderit gjë që e kemi bërë dhe kjo në mënyrë automatike do të thotë vazhdim edhe i kontratës, prandaj ndalesa e vlerës prej 34,216.87 Euro është kundërligjore dhe e pabazë sepse vlera e vonesës është 63,975.00 Euro dhe për këtë

vlerë keni të drejtë të aplikoni gjobë në vlerë 0.25% ditore. Përfundoi se, vlera e faturës ku edhe janë ndaluar mjetet si gjobë është për dy rezervuar njëri prej të cilave është montuar shumë kohë me herët por që fatura është bërë në fund të vitit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1590/22 i datës 28.07.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit SHSKUK – Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës me NRB 95000304 dhe NF 601789920, Lagja e Spitalit, Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.23/22 i datës 18.01.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë dhe e ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore, duke vendosur me decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pasi analizoj prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të gjeti se i njëjti është i bazuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarimore, përkatësisht nenin 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po 3 që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, ndërsa sipas nenit 29 par.1 nën paragrafi 1.3 të LPP-së përcaktohet se *“fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla”*. Prandaj, në këtë rast vlerëson se fatura me numër 21-SHV1-001-1408 të datës 21.12.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe neni 37 të LPP-së.

Prandaj, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si në dispozitivin të aktvendimit, duke e pranuar prapësimin e debitorit dhe duke e anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.23/22 të datës 18.01.2022, si dhe e ka përfunduar procedurën përmbarimore, me arsyetimin se në rastin konkret

Fatura: 21-SHV1-001-1408, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbaram, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Po ashtu, Kjo gjykatë vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka përfunduar edhe procedurën përmbaramore , me arsyetimin se duke u mbështetur në dispozitat në fuqi, rezulton se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbaram nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret fatura në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbaram nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta të jetë pranuar nga debitori.

Kjo gjykate i vlerësoi pretendimet e tjera dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuar , andaj , gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe kur e ka anuluar urdhrin përmbaramore P.nr.23/22 të datës 18.01.2022 i lejuar nga përmbaramesi privat dhe kur e ka përfunduar në tërësi procedurën përmbaramore. Po ashtu, Kjo Gjykate vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur ka konstatuar se debitori në prapësim ka bashkangjitur edhe Njoftimin e datës 21.01.2021 i përpiluar nga F.H UD Shef i Prokurimit – QKUK, për Shefin e zyrës për çështje juridike të QKUK-së dhe UD Shefin e Prokurimit të QKUK, me të cilin njofton të lartcekurit lidhur me kontratën për furnizimin me rezervar të Oksigjenit të Lëngët Medicinal dhe instalimi i tyre në Spitalet e SHSKUK, me nr. ref. 7001-20-290-111, se kreditori është vonuar në realizimin e së njëjtës për 210 ditë. Vonesa kap vlerën prej 65175.00 euro dhe në bazë të kushteve të Përgjithshme – për 4 Operatorin Ekonomik është shqiptuar dënimi për vonesat prej 210 ditëve në vlerë prej 34,216.87 €. Njoftimi i cili përfundon me konstatimin se kontrata është realizuar konform LPP-së dhe se nuk kanë asnjë obligimi ndaj Operatorit ekonomik lidhur me pretendimet e tij dhe të gjitha pagesat janë përfunduar konform kontratës. Andaj, mbi këtë bazë ka vendosur drejte kur ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP *“baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me çka debitori ka ofruar provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit lidhur me propozimin për përmbaram të lëshuar nga përmbaramesi privat, për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton së fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarami , për shkak se nuk i plotëson kushtet ligjore, për arsyes se fatura është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës se dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore,

të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbare.

Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe kur e ka anuluar urdhrin përmbare P.nr.23/22 të datës 18.01.2022 si dhe kur e ka përfunduar në tërësi procedurën në këtë çështje.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1269/23 dt.21.03.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova